

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Detaje nga atentati në Athinë, urdhri u dha nga koka e klanit 'Mafia e Burgjeve'!
ADRESA	https://prapaskena.com/2026/09/26/detaje-nga-atentati-ne-athine-urdhri-u-dha-nga-koka-e-klanit-mafia-e-burgjeve/
BURIMI	prapaskena.com
GJENDJA	online

KOHË


KAPUR NGA NE	26 shtator 2026, 11:44:06 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	26 shtator 2026, 11:43:16 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	3e952b4247212e43b955103079efa5c87a8d003669abccd813b8d96b03c2b748
TEKSTI	4475eeef62991d01d94cfe18c1a7e7cfd2a5b4bfb7f6b89a939e68963446ccf8
PAMJA	ef060a60692e56a5e5919b1e3b7ac5b58a0d6443db80b47cc6db94dc19f33f96

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	18bfd6a64e871d26af31076562c437e5ed8c2a42ab942c361361cd3ffd338eb3
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	0248b36ffa7147e2cf97c5d4334b4ac10f1e643fb19828b3303283d4e0ef69ec
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/18bfd6a64e871d26af31076562c437e5ed8c2a42ab942c361361cd3ffd338eb3>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Detaje nga atentati në Athinë, urdhri u dha nga koka e klanit 'Mafia e Burgjeve'!

Aktualitet

Publikuar: 26/09/2026

f X



Një vajzë 10-vjeçare me origjinë shqiptare u plagos gjatë një sulmi me armë ndaj lokalit të babait të saj në lagjen Agios Panteleimonas të Athinës.

E mitura ndodhej brenda kafenesë në momentin kur persona që lëviznin me një makinë hapën zjarr drejt fasadës.

E mitura është vajza e pronarit të lokalit, **Denis Luli**, 30-vjeç.

Sipas të dhënave paraprake të raportuara nga mediat greke, në automjet ndodheshin katër persona, të cilët qëlluan pa zbritur prej tij dhe më pas u larguan.

Në lokal ndodheshin edhe rreth dhjetë klientë.

Nga hetimet e para dyshohet se urdhri për atentatin është dhënë nga burgu, prej Klodian Lekocaj, një emër shumë i njohur për policinë greke.

Ende nuk dihet se kush ishte shënjestra dhe cilat ishin arsyet e konfliktit.

Por kush është Klodian Lekocaj?

Klod Cara, alias Klodian Lekocaj, 49 vjeç, një personazh kontrovers, është kthyer në qendër të vëmendjes vitet e fundit për shkak të etiketimit nga mediat greke si kreu i së ashtuquajturës "Mafia e Burgjeve". Se sa realisht ai është i tillë, kjo nuk dihet, pasi vetë ai, në daljet publike në media, e konsideron veten "të varfër", "të pafajshëm" dhe "të përdorur".

Ndërkohë, faktet, dëshmitë dhe përgjimet që disponon policia greke, sipas raportimeve, të çojnë drejt dyshimit se Lekocaj ka pasur dhe ka ende një rol të rëndësishëm në botën e

Me të lexuarat
Grupi kriminal i
AKSHI-t hap
klinikë kundër
plakjes në
emrin e Arlinda
Mekos
(kontabilistja e
Riv-
ish-shefja e
SHISH/ Nuk
shantazhoi
median, por
kërcënoi
armiq të e saj
Historia e
dyshtimë e
ankandit të
Llatjas, si u bë
Kujtim Llupa
pronar i Klubit
të Elbasanit
Me goditje me
pasqyrë, duke
më rrezikuar
jetën"/ Rrëfimi
i shefit të
Komisariatit të
Krajeve për v...
alarmin: Rusia
po përgatit
sulme me
dronë ndaj
Italisë, Spanjës
dhe Francës

identifikime të grupeve kriminale shqiptare dhe greke.

Lekocaj, në disa përgjime dhe dëshmi, është përmendur për lidhje me grupe kriminale, duke vënë në dispozicion të tyre ose të vetes persona të dyshuar si vrasës me pagesë. I tillë ishte edhe rasti i 14 shtatorit 2022, kur policia greke arrestoi rastësisht dy shqiptarët Viktor Çala, 39 vjeç, dhe Andi Beqiri, 23 vjeç. Ata u kapën në Athinë, pasi në automjetin e tyre u gjetën të fshehura dy kallashnikovë dhe një thikë, ndërsa në banesë u gjet një pistoletë.

Hetimi i policisë zbuloi se Çala ishte autor i vrasjes së një greku dhe i tentativës për vrasjen e një shqiptari, të dyja ngjarje të ndodhura në muajin korrik 2022.

Për vrasjen e grekut, ai deklaroi se ishte urdhëruar nga Klodian Lekocaj, për shkak të prishjes së pazareve të drogës. Kështu, "Klodit", i cili në kartelat greke njihet edhe si "Luli" apo "Ilia", iu shtua atëherë edhe një akuzë tjetër, pas akuzave të mëparshme për urdhërimin e vrasjeve të avokatit grek Mixalis Zafiropoulos, të të burgosurit Arbër Bako dhe të të burgosurit Bardhyl Tusha, përfshirje në tentativën e vrasjes së një pakistanezi, gjobëvënie ndaj ish-ministrit grek Dimitri Tsovola, ndihmë në arratisjen e të burgosurve Leonard dhe Elvis Pepa etj.

Lekocaj, në fakt, përveç urdhrave, ka precedentë edhe si autor i drejtpërdrejtë. Fillimisht është arrestuar në vitin 1997 për vjedhje. Në vitin 2003 ishte arratisur nga burgu i Volosit, ndërsa në vitin 2005, në Agios Panteleimonas, plagosi me armë zjarri në bark një shqiptar. Më pas, në të njëjtin vend, në vitin 2006, bashkë me dy shqiptarë, plagosi me thikë një bashkëkombas të tij.

TAG:

Atentati

Athinë

mafia

Të ngjashme



Shembja e godinës në Athinë, motër e vëlla mes viktimave, zbardhen identitetet e shqiptarëve që humbën jetën



DETAJE/ SPAK operacion në Shkodër e Tiranë: Arrestohet i "forti" i Shkodrës, rishpallet në kërkim Endrit Dokle!



Po hynte në Shqipëri, arrestohet sapo zbret nga avioni ukrainasi i kërkuar për trafik droge dhe organizatë kriminale!

Prapaskena

'Prapaskena' lindi si një nismë e një grupi gazetarësh me përvojë dhe plotësisht të

Copyrights

Çdo kopjim, përdorim apo riprodhim i paautorizuar i këtij materiali është i ndaluar

Kategoritë

KREU INVESTIGIM

KRIM & KORRUPTION, DOSIE ROZË

pavarur nga çdo parti politike, grup interesash apo klane biznesi, me qëllim për të thënë çdo të vërtetë të guximshme me interes publik. 'Prapaskena' është një media e lirë dhe e pakompromis, e cila ka si qëllim informimin e opinionit publik në mënyrë të paanshme, profesionale dhe në dritën e të vërtetës, mbi çështje që lidhen me korrupsionin politik, krimin, pandëshkueshmërinë, grabitjen e pasurive publike, mbi reformat, sfidat kombëtare dhe lidhjet e padukshme mes partive politike, mediave të njësuara me interesat klienteliste, krimin dhe biznesit jo të ndershëm, të cilët në bashkëpunim përvetësojnë paratë dhe pasuritë publike.'

dhe mund të sjellë ndjekje ligjore. Ju lutemi respektoni punën dhe përpjekjen tonë duke mos e shkelur këtë parim.

[KRYESORE](#) [POLITIKË](#) [EKONOMI](#)

[ANALIZË](#) [RAJON](#) [KULTURË](#) [SPORT](#)



Email: [\[email protected\]](#)

Copyright © 2025. All Rights Reserved by Prapaskena

[Privacy Policy](#) | [Cookies](#)

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.